



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 5 QERSHOR 2008**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. JUNA 2008. GODINE**

QERSHOR – JUNI

2008

Seancën plenare e kryesoi Kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kryeministër,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Ju njoftoj se në sallë janë të pranishëm 84 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuar në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin lidhur me të, sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, në seancën e sotme plenare do të procedohen për leximin e dytë projektligjet e miratuara më 4 qershor 2008 në leximin e parë.

Rendi i ditës, së bashku me materialet, iu është shpërndarë deputetëve.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj zotin Fehmi Mujota, që në emër të Komisionit ad-hoc, ta arsyetojë Raportin, me rekomandime.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit! Zoti Kryetar,
Zoti Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,
Komisioni ad-hoc, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, të datës 15 shkurt 2008, në mbledhjen e mbajtur më 5 qershor 2008, shqyrtoi projektligjet e grupit të katërt nga propozimi i Marti Ahtisarit, të propozuara nga Qeveria dhe Kuvendi dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqes këtë

R A P O R T

Në bazë të punës që ka bërë Komisioni ad-hoc gjatë ditës së sotme, më lejoni që të njoftoj Kuvendin e Republikës së Kosovës se në shumicën e rasteve kemi pasur konsensus të plotë si Komision ad-hoc dhe kemi pasur një debat të gjerë dhe të thellë për shumë çështje, të cilat, ndoshta, nuk kanë një pajtueshmëri të plotë dhe mund të kemi diskutime shtesë, por mendimi i të gjithë anëtarëve të Komisionit ishte për të prezantuar këto 19 amendamente në këto pesë projektligje të cilat i kemi pasur në shqyrtim.

Më lejon të falënderoj të gjithë anëtarët e Komisionit ad-hoc dhe grupet parlamentare që kanë ofruar amendamente shtesë, grupet joformale dhe shoqërinë civile, që është përpjekur të sjellë ndonjë propozim, por në radhë të parë kontributin e veçantë të anëtarëve të Kuvendit të cilët kanë sjellë një qëndrim, do të them, të drejtë dhe të qartë në raport me ligjet dhe me marrëveshjen që kemi bërë në këtë kohë.

Amendamentet janë nxjerrë në bazë të marrëveshjes ose konsensusit politik, në bazë të përkrahjes nga grupet parlamentare në seancën e parë plenare dhe në bazë të arsytimit që ka bërë Qeveria për ligjet në fjalë.

Amendamentet e nxjerra sjellin disa ndryshime, të cilat, në thelb nuk e ndryshojnë shumë përbërjen e ligjeve, por megjithatë rregullojnë disa çështje të cilat mendojmë se kanë një kuptim dhe një domethënie për zbatimin e tyre në praktikë.

Të shikojmë radhazi dhe të shohim se në Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës kemi gjithsej 13 amendamente, prej të cilave, në amendamentin 10, për hir të korrektësisë, megjithë përpjekjet për të gjetur një partneritet, kompromis dhe aprovim të përbashkët, neni 10 ka pasur një diskutim, i cili ka ngelur me propozimin që e ka sjellë Komisioni ad-hoc meqë mendojmë se ka qenë një ndryshim jothelbësor, por ka qenë një ndryshim vetëm në radhitje dhe në riformulim të këtij neni.

Për të mos marrë kohë më tepër për të gjitha amendamentet që kemi afuar para seancës plenare, Komisioni ad-hoc, me këto propozime dhe amendamente që ka ardhur para jush, kërkon që ligjet të aprovohen në tërësi.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Asnjë kryetar i grupeve parlamentare nuk e ka shfrytëzuar të drejtën për të marrë fjalën, prandaj kalojmë në votim të amendamenteve veç e veç.

Të pranishëm në sallë janë 85 deputetë.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për të votuar. Votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime – miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime – miratohet amendamenti 2.

A ka ndokush nga deputetët që nuk e ka kartelën? Mirë, faleminderit!

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 80 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime – miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime – miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 79 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime – miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 5 abstenime – miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 78 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime – miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, 1 “kundër” dhe 5 abstenime – miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime – miratohet amendamenti 9.

Urdhëroni, zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, Kryetar!

Desha ta bëj vetëm një plotësim lidhur me Kushtetutën e që ka të bëjë me amendamentin 10. Kur thuhet “përfaqësojmë komunitetin shumicë shqiptar”, ju e dini që me Kushtetutë është e paraparë në mënyrë taksative: “Kosova përbëhet nga shqiptarët dhe komunitetet tjera.”. Pra, komuniteti nuk vlen për shqiptarët.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Fehmi Mujota.

FEHMI MUJOTA: Propozimi i zëvendëskryeministrit, sigurisht i referohet saktësisht Kushtetutës, por meqë me ligj kanë qenë të formuluar në këtë mënyrë, ne nuk i jemi shmangur fjalës “komunitet shumicë shqiptarë”. Në fakt, të jemi shumë korrektë, fjala “shqiptarë” ka qenë problem për komunitetin ndërkombëtar që ta pranojë, ndërsa ne iu kemi referuar fjalës “shumicë” dhe “pakicë”, prandaj mendoj se fjala “komunitet” nuk është ndonjë problem e të hiqet, mbetet “shumicë shqiptarë dhe komuniteteve tjera”. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka zëvendëskryeministri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Shikoni, unë nuk mendova që të jap sqarim jo vetëm në këtë ligj. Në Komision kushtetues kemi bërë debat të gjatë, kemi bërë shumë negociata të gjithë anëtarët e Komisionit kushtetues dhe kemi ardhur në përfundim: Ata që quhen komunitete në Kosovë, nuk janë shqiptarë. Pra, kemi thënë “shqiptarët dhe komunitetet tjera” dhe nuk ka nevojë që asnjë herë para fjalës “shqiptar” të përmendet fjala “komunitet”. Le të mbetet: “shumicës shqiptare”.

KRYETARI: Tash e kemi edhe një propozim. Së pari e vë në votim variantin e Komisionit, pastaj propozimin e zëvendëskryeministrit. Fehmi Mujota e kërkon fjalën.

FEHMI MUJOTA: Zoti Kryetar, interpretimi është shumë i saktë dhe Komisioni natyrisht se pajtohet që fjala “komunitet” të hiqet dhe të mbetet “shumicë shqiptare dhe komunitetet tjera”. Pra, të hiqet fjala “komunitete” dhe vazhdon më tutje...

KRYETARI: Do të thotë, e votojmë amendamentin numër 10, pa fjalën “komunitet”.

(Ndërhyrje nga deputetët)

Ju lutem, të dëgjohemi. Nuk ka këtu kushedi çfarë ndryshimi, por megjithatë do ta bëjmë këtë.

“Në mesin e subjekteve politike që përfaqësojnë shumicën shqiptare, që kanë fituar së paku 5% nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme” dhe vazhdon fjalia.

A jeni për këtë variant? Mirë, faleminderit!

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 72 vota “për”, 3 vota “kundër” dhe 4 abstenime – miratohet amendamenti në formën siç e lexova.

Vazhdojmë me amendamentin 11.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime – miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 78 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime – miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13 dhe i fundit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 79 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime – miratohet amendamenti 13.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim të tekstit të ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 10 “kundër” dhe 7 abstenime – miratohet Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Fjalën e ka deputeti Fehmi Mujota.

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Për të gjitha amendamentet që janë në vazhdimësi, mendoj se nuk ka nevojë të bëhet një arsyetim i veçantë, meqë nuk kam dashur ta lodhi seancën me arsyetime veç e veç për secilën fjalë të shtuar. Ne nuk kemi ndonjë vërejtje konkrete dhe mendoj të shkohet me votimin e tyre ashtu siç janë të prezantuara.

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Këtu në ekran e kam emrin e Lutfi Hazirit. Është paraqitur më herët! Atëherë, tërhiq se kërkon fjalë. Në ekran e kam edhe Slobodan Petroviqin, pra edhe ky le të tërhiqet nëse nuk do që ta marrë fjalën. Faleminderit!

Vazhdojmë më tutje me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Meqenëse nuk ka të paraqitur për fjalë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 70 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 7 abstenime – miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 74 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime – miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3 dhe i fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 79 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime – miratohet amendamenti 3.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votimin e tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 76 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 8 abstenime – miratohet Ligji për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Në radhë është pika:

- Shqyrtimi i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Meqenëse nuk kemi të paraqitur për të marrë fjalën, vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime – miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 79 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime – miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 78 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime – miratohet amendamenti 3.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 79 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime – miratohet Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në sallë janë të pranishëm 85 deputetë.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Të paraqitur për debat, nuk ka.

Nuk ka as amendamente të propozuara.

E votojmë Projektligjin në tërësi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime – Kuvendi miratoi Ligjin për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe të Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Pika e pestë dhe e fundit është:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Hekurudhat e Kosovës

Komisioni ad-hoc ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me rekomandime.

Raporti i Komisionit iu është shpërndarë deputetëve.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, Kryetar!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Nuk kam vërejtje në këtë drejtim, por ne jemi marrë vesh në Komision që projektligjet në titull të adaptohen sipas Kushtetutës. Unë vetëm dëshiroj ta kthej vëmendjen për këtë dhe t’ju lus që këtë projektligj ta paraqitni si: Projektligji për Hekurudhat e Republikës së Kosovës. Diçka tjetër nuk kam. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit! Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, asnjë kundër dhe 1 abstenim – Kuvendi miratoi Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë!

Mirë u pafshim në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia e Transkripteve